

# THUAJ,



## PROCESI ZGJEDHOR NË DEMOKRACI

BLENDA (15), EDISON (14), ERMIRA (14), DRIN (14), DIELLZA (14), ARLIND (14), ELSA (14),

KRENARE (14)



### Në demokraci, ne kemi mundësi të zgjedhim se kush do të na përfaqësojë në të ardhmen

Kosova është shpallur shtet demokratik më 17 shkurt, 2008. Që nga ajo ditë, ne gëzojmë të drejta të shumta, shumicën e të cilave më parë nuk i kemi pasur.

Formë e qeverisjes në shtetin tonë është demokracia përfaqësuese. Çka do të thotë kjo? Demokraci do të thotë kur populli e ka në dorë udhëheqjen e shtetit. Ndërsa, demokraci përfaqësuese do të thotë kur qytetarët i zgjedhin përfaqësuesit e tyre, me anë të votës. Çdo qytetar i Republikës së Kosovës, i cili e ka arritur moshën 18 vjeçare ka të drejtë të votojë. Meqenëse në Kosovë kemi sistem parlamentar, përfaqësues të popullit janë deputetët, të cilët janë zgjedhur prej vet qytetarëve.

Le të supozojmë se sot është ditë shumë e rëndësishme, sepse pikërisht sot po realizohet procesi zgjedhor në Kosovë. Në këtë proces, kemi tri parti të ndryshme. Partia 1, në krye me kryetarin Arlind Berisha, ka premtuar që në shtetin tonë, gjatë mandatit katër vjeçar, do të ketë ngritje të zhvillimit ekonomik. Partia 2, në krye me kryetaren Blenda Berisha, fokusin e ka tek ngritja e nivelit arsimor. Ndërsa, Partia 3, në krye me kryetarin Drin Beqiri, premtun se pikat në të cilat do të ketë ngritje zhvillimi janë: siguria e shtetit, zhvillimi i bujqësisë, si dhe zgjidhja e problemit të ndotjes së ajrit në Kosovë.

Ne si qytetarë kemi dëshira, interesa si dhe kërkesa

të ndryshme prej njëri-tjetrit. Prandaj, edhe secili prej ne do të votojë për partinë, e cila e ka programin që përputhet me interesat tona.

Në rastin e shembullit tonë, partia e cila mbledhi më shumë vota ishte Partia 3, meqenëse për neve si qytetarë është shumë e rëndësishme të kemi siguri shtetërore. Mirëpo, duke mos i anashkaluar edhe pikat e tjera të programit të partisë, të cilat gjithashtu janë shumë të rëndësishme.


Ne kemi diskutuar në grup për elementet e demokracisë që janë: barazia, respekti, toleranca, etj. Kemi diskutuar gjithashtu edhe për rëndësinë e procesit zgjedhor. Njëkohësisht, kemi bërë krahasimin e demokracisë së atëhershme me atë të sotme. Të gjitha këto na kanë bërë të reflektojmë dhe me të vërtetë ta vlerësojmë këtë që ne e kemi.



Demokracia na fton që ne ta pranojmë njëri-tjetrin për atë që jemi

# NDARJA E DETYRAVE DHE PËRGJEGJËSIVE

JONA (14), ELDA (14), BLINERA (15), RINESA (14), ALTRESA (14), LAVDRESA (15), FORTESA (14),  
BESARTA (14)




## Në demokraci bëhet ndarja e detyrave dhe përgjegjësisve. Se si bëhet kjo, lexojeni artikullin në vijim

Ne në klasën tonë përmes votave tona zgjedhim kryesinë. Pastaj, bëjmë ndarjen e detyrave, ku zgjedhim kryetarin, sekretarin dhe arkatarin e klasës. Këtë ndarje e bëjmë në mënyrë që secili ta kryej detyrën në mënyrë të pavarur dhe të udhëhiqet klasa në mënyrë më të mirë. Por, asnjëherë nuk e kemi menduar se pikërisht kjo ndarje e detyrave dhe përgjegjësisve ndodh edhe në shtetet demokratike, e që njihet si Ndarje e

Pasi që deputetët miratojnë ligjet, ato vihen në funksion nga dega tjetër e pushtetit, e cila është Qeveria. Qeveria udhëhiqet nga Kryeministri, i mbështetur nga zëvendëskryeministrat dhe ministrat e ministrive të ndryshme. Detyra e tyre është ta qeverisin vendin në mënyrë më të mirë të mundshme. Kjo për arsye se në një shtet demokratik, secili duhet të ndihet i lumtur dhe i sigurt brenda shtetit të tij.

E për të qenë të sigurt, duhet t'i respektojmë rregullat dhe ligjet. Për të vendosur siguri dhe drejtësi kemi dëgën tjetër të pushtetit të quajtur gjyqësor.

Gjykata vendos drejtësinë në vend duke i gjykuar personat, për të cilët dyshohet se kanë shkelur ligjet. Pra, qytetarë të dashur, kjo është demokracia, ku secili duhet ta kryejë punën e vet me përkushtim dhe përgjegjësi, duke vendosur gjithmonë në rend të parë kërkesat dhe interesat e popullit. Prandaj, ju ftojme edhe juve të respektoni ligjet e miratuara nga Kuvendi, sepse kështu formohet tutje shteti ynë demokratik.



Pushtetit. Rolin kryesor në ndarjen e pushtetit e mban populli, sepse ai fuqinë e vet ua beson deputetëve. Ndarja e pushtetit në demokraci bëhet në tri degë, të cilat janë: Kuvendi që njihet si Pushteti Legjislativ, Qeveria që është e njohur si Pushteti Ekzekutiv dhe Gjykata si Pushteti Gjyqësor. Kuvendi bën propozimin dhe miratimin e ligjeve. Ai përbëhet prej 120 deputetëve, ndërsa prej tyre 20 janë nga komunitetet jo shumicë.



Ne do të ndërtojmë edhe më shumë demokracinë

## NE FLASIM PËR QYTETARËT AKTIV

ENGJËLLUSHA (15), ANTIGONA (15), AIDA (14), SHKODRANE (14)

**Lexues të dashur, ne si fëmijë duam t'iu tregojmë për disa gjëra, që i kemi mësuar sot. Nëse doni të mësoni se çfarë janë ato, lexoni më poshtë**

Ne njohim një vajzë, e cila quhet Venera. Ajo është një vajzë 18 vjeçare dhe jeton me familjen e saj në qytetin e Kamenicës. Një ditë, teksa ne ishim duke shkuar në bibliotekën e qytetit, ajo erdhi dhe kërkoi ndihmë nga ne. Venera dëshironte të dinte se si ajo mund të bëhej një qytetare aktive. Ne pasi që kishim mësuar në shkollë pikërisht në atë ditë për qytetarët aktiv, filluam t'i shpjegojmë asaj mbi këtë temë. Por, çfarë i thamë ne? Ne filluam duke i treguar Venerës se ajo së pari jeton në një vend demokratik ku fuqia i takon popullit. Prandaj, ajo si qytetare e Kosovës ka fuqi ta ndryshojë vendin e saj. Këtë mund ta arrijë duke votuar. Venera mund të votoj pasi që është një vajzë mbi moshën 18 vjeçare dhe vota saj nuk duhet të ndikohet nga askush.

Një mënyrë tjetër sesi Venera mund të jetë aktive është përmes nënshkrimit të peticioneve të ndryshme për çështjet, të cilat asaj i interesojnë.

Po ashtu, në rast të pakënaqësisë ajo ka të drejtën e protestës. Ashtu si Venera këtë të drejtë e gëzojnë edhe të tjerët, por të gjithë duhet të protestojnë në mënyrë paqësore. Ajo çfarë mund të bëjë Venera për të arritur qëllimin e saj është të ndihmoj sa më shumë vendin dhe njashtu të mbroj ambientin ku jeton. Gjithashtu në mënyrë vullnetare mund t'i bashkangjitet Kryqit të Kuq apo organizatave të tjera.

Pas kësaj bisede Venera u bind se ajo mund të ndryshojë plotësisht vendin e saj. A dëshironi t'i bashkangjiteni Venerës edhe ju?



Venera ka mësuar se ajo mund të votoj



Qytetarët e mirë protestojnë për kërkesat e tyre



Venera, po ashtu, nënshkruan peticione të ndryshme



Qytetarët dhe gazetaret shumë aktive

# MEDIA - BURIM INFORMUES DEMOKRATIK

LORESA (14), ERIOLA (14), ATLANT (14), QËNDRESA (15), ALBIN (14)



**A keni menduar ndonjëherë gjërsa keni qenë duke shikuar televizion se çfarë rëndësie ka media? Ne, nxënësit nga Kamenica, në këtë artikull kemi shkruar pikërisht për këtë temë**

Artikullin dëshirojmë ta fillojmë duke iu treguar se media luan rol shumë të rëndësishëm në vendin tonë dhe jetërat tona. Pasi nëpërmjet medias ne mund të mësojmë për ngjarjet në vendin tonë, por edhe më larg. Ne mund të informohemi për ndonjë fatkeqësi

Për t'u arritur kjo, gazetarët duhet të ndjejnë një përgjegjësi të madhe për punën që bëjnë dhe ta kryejnë atë siç duhet.

E në anën tjetër, edhe qytetarët duhet të kenë edukim medial. Nëse nuk e keni aq të qartë këtë term, atëherë ne do t'ua shpjegojmë. Qytetarët e edukuar për sa i përket mediave, kërkojnë gjithmonë burime të besueshme. Ata nuk përdorin vetëm një lloj të medias, por disa lloje të ndryshme të saj.


Në rast që ndodh që ne të marrim ndonjë informatë, së cilës nuk i besojmë edhe aq, ne duhet gjithashtu t' hulumtojmë për të njëjtin lajm edhe në medime të tjera. Sipas neve, ndikimi i mediave është shumë i madh për shkak se ato mund të ndryshojnë mendimet e qytetarëve. Për këtë arsye, të gjithë qytetarët duhet t'i përdorin ato në mënyrën më të drejtë të mundur që të forcohet demokracia e vendit tonë. Ne ju themi faleminderit që lexuat artikullin tonë.



që ka ndodhur, ose për ndonjë libër që sapo është botuar, ose edhe për kandidatët e partive politike, të cilët kandidojnë për kryetar komune dhe asambleistë në zgjedhjet lokale, etj. Në media punojnë gazetarët, të cilët na informojnë për ngjarjet e fundit. Ne mendojmë se gazetarët duhet të kenë disa parime të punës. Ata duhet të jenë të saktë, objektiv dhe të paanshëm.



Forca e mediave është në krahun tonë



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e Kombit“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-1, X-2 & IX-3  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Kamenicë

